REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 272/19
Date/Datum. 25.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Paneli Shqyrtues - OSHP	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Safije Saramati – ekspert Shqyrtues Zenel Hisenaj – Ekspert Teknik		
Lënda:	Raporti i Super ekspertizës, lidhur me Lenden me Nr. 272/19 të parashtruar nga OE **"Matrix IM" shpk & X shpk**		
Datë	25. 06. 2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt:**03.06.2019** me nr. **272/19** të parashtruar nga OE **"Matrix IM" shpk & X shpk**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Fumizim me pajisje për zë"** me nr. të prokurimit: **623-19-1778-1-3-6** , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK-Rahovec**.
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KK-Rahovec**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I *EKSPERTIT TEKNIK*

		17.06.2019	**25.06.2019**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të ekspertit.*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

1). Me datën: **03.06.2019** OE **"Matrix IM" shpk & X shpk shpk"**, ka parashtruar ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Fumizim me pajisje për zë"** me nr. të prokurimit: **623-19-1778-1-3-6,** iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Rahovec.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues dhe teknik i kane shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues "Matrix IM" shpk & X shpk shpk- Prishtinë.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues **"Matrix IM" shpk & X shpk - shpk Prishtinë**, janë:

- Neni 1 i LPP-se
- Neni 6 i LPP-se
- Neni 7 i LPP-se
- Neni 13 i LPP-se
- Neni 59 i LPP-se
- Neni 60 i LPP-se
- Neni 72 i LPP-se

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe te detajuar per faktet dhe argumentet te cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne jemi njoftuar me letrën standarde për tenderues të eliminuar me dt:16.05.2019, mirëpo iu sqarojmë se ju na keni eliminuar pa bazë ligjore sepse ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Fillimisht ju na keni rekomanduar për kontratë si ofertues i përgjegjshëm, mirëpo pas kërkesës për rishqyrtim nga ana e OE **"Eor Group Shpk",** në keni kërkuar sqarime shtesë dhe pastaj nuk i keni marr për bazë këto sqarime të ofruara nga ne.

Arsyeja juaj e eliminimit, se ne nuk e plotësojmë kërkesën "Lista e projekteve te kryera në Lëmin e furnizimeve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Furnizimet e kryera, shumën e kontratës, vendit dhe Nr. e Prokurimit — duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, e përcjellë me Kopje të Referencës ose Pranimit të furnizimeve ti kryera", është e paqëndrueshme dhe e pa bazuar.

Ne gjatë sqarimeve ju kemi ofruar listën me kontrata dhe referenca/pranime teknike ku mund të shihet se e kemi plotësuar kërkesën e lartpërmendur në lidhje kontrata dhe referenca të natyrës Së ngjashme, sepse kërkesa nuk ka qenë për kontrata të natyrës Së njëjtë por të natyrës së ngjashme, mirëpo në kuadër të kontratave të prezantuara ka edhe furnizime të njëjta, pra ka furnizim të pajisjeve për zërim.

Ju si autoritet kontraktues e keni rekomanduar për kontratë një operator ekonomik (Eor Group Shpk) i cili nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes Së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

1. Arsyet se përse është i papërgjegjshëm OE i rekomanduar për kontratë janë si në vijim:

Deklarata nën betim - mungon hederi dhe foteri si ne dosjen e tenderit pra nuk është numri i prokurimit dhe emri i projektit

2. Te pozita, Shpresa Veliu ekziston si menaxhere ndërsa në dokumente te biznesit është si drejtoresh, kurse Adresa dallon nga dokumentet e biznesit.

3. Deklarata për specifikat teknike :

Mungon numri i prokurimit dhe autoriteti kontraktues se kujt ju ka drejtuar

4. Deklarata për liferimin e pajisjeve nuk është konform kërkesë së AK-së sepse Mungon numri i prokurimit dhe emri i autoriteti kontraktues, prandaj nuk është e vlefshme.

5. Vërtetimi i gjykatës themelore Prishtinë, nuk është ofruar siç është kërkuar, kopje e noterizuar, por është ofruar vetëm kopj

6. Katallogu i ofruar nga OE fitues

Pozicini 1, në paramasë është kërkuar vetëm 1 model nga AK, ndërsa OE i shpallur fitues i ka ofruar disa modele si p.sh janë ofruar 12 modele ku një pjesë e këtyre nuk i plotëson specikat teknike të parapara në paramasë. Pra OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me variante, ndërsa variantet me dosje të tenderit nuk kanë qenë të autorizuara.

Katalogu_tasker

I.Pr:010 XD
2.PR012D
3.PR012XD
4.PR 015D
5.PR015XD
6.PR0210SUBA
7.PRD18SUBA
8.PR 012M
9.PR015
10.PR015X
11.PR0210S
12.PR018S

POZICIONI 3, Në paramasë -është kërkuar kabëll lidhese 300 metra, ndërsa OE fitues ka ofruar mbi 20 modele te kabllove bazuar ne katallogun e ofruar.Pra OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me variante, ndërsa variantet me dosje të tenderit nuk kanë qenë të autorizuara.

I.C265 2x1,00 mm2
2.C275 2x1,50 mm 2
3.C266 2x2,00 mm2
4.C276 2x2,50 mm 2
5.C267 2x3,00 mr-n2
6.C277 2x4,00 mm2
7.C265 L.S.Z.H. 2x1,00 mm2
8.C275 L.S.Z.H. 2x1,50 mm2
9C276 L.S.Z.H. 2x2,50 mm 2
10.C277 L.S.Z.H. 2x4,00 mm 2
11.C268 2x1,50 mm2
12.+2x2,50 mm 2
13.C288 4x2,50 mm2
14.C279 4x4,00 mm2
15.C269 8x2,50 mm 2
16.C289 4x2,50 mm 2
17.+4x4,00 mm 2
18.C282 8x4,00 mm
19.TSK1125 1x2,50 mm 2
20.TSK1126 1x4,00 mm2
21.T20 2x17 AWG
22.T21 2x16 AWG
23.T22 2x14 AWG
24.T23 2x13 AWG
25.T24 2x12 AWG
26.T25 2x11 AWG
27.T26 2x16 AWG
28.+2x13 AWG
29.T27 4x13 AWG
30.TSK101 2x16 AWG
31.TSK103 2x14 AWG
32.TSK105 2x12 AWG
33.TSK106 2x11 AWG
34.TSk107 2x9 AWG
34.TSk108 2x8 AWG
35.TSk1112 2x1,00 mm 2
37.TSk1113 2x1,50 mm 2
38.TSk1115 2x2,50 mm2
Tsk201 2x1,00 mm2
TSk202 2x1,50 mm2

TSk203 2x2,50 mm 2
TSk301 2x1,00 mm2
TSk302 2x1,50 mm 2
TSk303 2x2,50 mm 2 .
C101 2x0,35 mm2
C101 2x0,50 mm2
C102 2x0,75 mm2
C102 2x1,00 mm2
C102 2x1,50 mm 2
C102 2x2,00 mm2
C102 2x2,50 mm2
C102 2x4,00 mm2
C101 2x0,35 mm2
C101 2x0,50 mm2
C102 2x0,75 mm2
C102 2x1,00 mm2
C102 2x1,50 mm2
C102 2x2,00 mm2
C102 2x2,50 mm2
C102 2x4,00 mm
TSK52 2x0,75 mm2
TSK53 2x1,00 mm 2
TSK54 2x1,50 mm2
TSK55 2x2,00 mm2
TSK56 2x2,50 mm 2
TSK58 2x4,00 mm2
TSK51- 5 2x0,50 mm 2
TSK51- 10 2x0,50 mm 2
TSK51- 20 2x0,50 mm 2
TSK53- 5 2x1,00 mm2
TSK53- 10 2x1,00 mm 2
TSK53- 20 2x1,00 mm 2
TSK54- 5 2x1,50 mm 2
TSK54- 10 2x1,50 mm 2
TSK54- 20 2x1,50 mm 2
TSK1013 2x0,75 mm 2
TSK1014 2x1,00 mm 2
TSK1015 2x1,50 mm2
TSK1016 2x2,50 mm 2
TSK61 2x0,50 mm 2
TSK63 2x1,00 mm2
TSK64 2x1,50 mm2
TSK65 2x2,00 mm2
TSK66 2x2,50 mm2
TSK67 2x3,00 mm2
TSK68 2x4,00 mm 2
TSK61- 5 2x0,50 mm2
TSK61- 10 2x0,50 mm 2
TSK61- 20 2x0,50 mm2
TSK63- 5 2x1,00 mm 2
TSK63- 10 2x1,00 mm 2
TSK63- 20 2x1,00 mm2
TSK64- 5 2x1,50 mm2
TSK64- 10 2x1,50 mm2
TSK64- 20 2x1,50 mm 2

C191TS 2x1,00 mm2
C192TS 2x1,50 mm 2
C193TS 2x2,50 mm2
CIOOTS 2x3,00 mm2
C232TS 2x2,00 mm 2
C271TS 2x1,50 mm2
C270TS 2x2,50 mm 2
TSK1008 2x1,00 mm 2

C233TS 4x1,50 mm2 FAQE 25 KATALLOGI
C100 2x0,35 mm2
C100 2x0,50 mm 2
C100 2x0,75 mm2
C100 2x1,00 mm2
C100 2x1,50 mm2
C100 2x2,00 mm2
TSK71 2x0,50 mm2
TSK72 2x0,75 mm 2
TSK73 2x1,00 mm 2
TSK74 2x1,50 mm2
TSK76 2x2,50 mm2
TSK78 2x4,00 mm2
C234 1x4,00 mm2
C235 1x6,00 mm2
C236 1x8,00 mm2

C300 1x0,22 mm2 1,5 FAQE 27 KATALLOGI
TSK1030 1x0,20 mm2
T33 1x0,50 mm2

TSK10311x0,50 mm2 FAQE 28 KATALLOGI
C129 1x0,35 mm2
C195 1X0,50 mm2
fAQE 37 KATALLOGI
C402 mm 2
C404 mm 2
C408 mm2
C412 mm 2
C416 mm2
C424 mm 2
C432 mm 2
C436 mm 2
C448 mm 2
C452 mm2

7. PARAMASA POZICIONI 1 5

OE fitues nuk ka specifikuar cilat konektor, po ashtu ka ofruar disa seri të konvektorëve prej faqes 27 deri ne 37, pra plotë IO faqe me konektor të ndryshëm. Pra OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me variante, ndërsa variantet me dosje të tenderit nuk kanë qenë të autorizuara.
faqe 37 katalogu.
NP3X-BAG-max. 0 7 mm.-SP55max. 0 5 mm.SP81max. 5 mm.-SP80max. 5 mm.SPF3XLRMmax. 0 7 mm.-SPM3XLRMmax. 7 mm.-SPS6.3max. 6,5 mm.

8. POZICIONI 1 6

Mungojnë në tërësi specifikat teknike të PC-llaptopit të kërkuar dheOE fitues nuk ka kod për tregtimin e PC në veprimtaritë e biznesit.

9. POZICIONI 1 7-projektor

Mungon në tërësi specifikimi tekinik i projektorit, nuk është fare në katalog, ndërsa në FTD kërkohet broshura.

10. POZICIONI 1 8- përderisa për projektor

Mungon ne tërësi specifikimi teknik i projektorit, nuk është fare në katalog ne FTD kërkohet broshura.

11. POZICIONI 1 10-

AK ka kërkuar vetëm 1 mikset me 16 kanale, ndërsa OE fitues ka ofruar 2 modele 8 kanalesh dhe 16 kanalesh, ndërsa nuk i përkrah 740-786 MHZ dhe frekueca ne 150m katalogu i miksetes 3/16MPM SERIES MANUAL_v1.1, pra ka ofruar misket me të vogël se që ka kërkuar AK-ja.
Mikseta nuk përkrah vifi mikrofon shih katalogun -PM_SERIES_MANUAL_v1.1

12. Pozicioni i 2 Fumizim me 2 wireles hand mic -Pajisja e ofruar përkrah vetëm 1 dhe gjuha e përshkrimit teknik është bullgare.

Komplet katalogu është ofruar në gjuhën bullgare i cili fakt është në kundërshtim me nenin 13 paragrafi 4 i LPP-së, prandaj OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm.
AK-ja ka kërkuar 40 hz deri 18000 hz, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar 50Hz - 15,OOOHz, Pra nuk janë përmbushur specifikimet teknike nga OE i rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura rezulton se ju nuk e keni respektuar nenin 59 të LPP-së, sepse na keni eliminuar neve edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe e keni rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili është plotësisht i papërgjegjshëm për faktet që u cekën më lartë, duke vepruar edhe në kundërshtim me nenin 60 të LPP-së, sepse kriter kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Janë pranuar dokumente në gjuhën Bullgare në kundërshtim me nenin 13.4 të LPP-së.

Gjithashtu ne jemi diskriminuar në kundërshtim me nenin paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së, sepse aty parashihet që Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Ky diskriminim është bërë Për faktin se ne si kompani i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes Së tenderit dhe të njoftimit Për kontratë në tri lotet, ku jemi eliminuar.

Po ashtu nuk është shfrytëzuar edhe neni 59.2 dhe 72 i LPP-së në mënyrë të drejtë dhe objektive, sepse ne i kemi ofruar dëshmitë e mjaftueshme Për listë të kontratve dhe referenca të natyrës Së ngjashme.
Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të mermi:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa Për rishqyrtim e OE "MATRIX IM SHPK"

ANULOHET, vendimi dhe njoftimi Për dhënie të kontratës dhe të rishqyrtohenofertat sipas dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të FDT-së e të njoftimit Për kontratë, në të kundërtën, ne do të jemi të detyruar të vazhdojmë procedurat e ankimimit në të gjitha instancat tjera në Republikën e Kosovës.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë: 05.04.2019

Lloji i procedurës së aplikuar:.....Kuotim Çmimi

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....Kontratë publike, Furnizim

Vlera e parashikuar e kontratës:.....6,960.00 €

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)..... Çmimi më i ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....10.04.2019

Kriteret për vlerësim:

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

1. Kërkesa 1 Deklaratë nën betim – Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L092 Ligjin Nr. 04 L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.

2. Kërkesa 2 Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore, se ju nuk keni obligime borxhe te tatimeve në ATK. Vlefshmëria e vërtetimit duhet te jete maksimumi 90 dite nga data e dëshmimit deri ne datën e hapjes se ofertave. Vërtetimi kërkohet origjinal ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës.

3. Kërkesa 3 Dëshmi se kompania (biznesi) nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë te lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 180 dite nga data e lëshimit deri ne ditën e dhënies.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Deklarata nën betim – e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes).
2. Dëshmia 2 Vërtetimi i ATK (i verifikuar ne web faqen e ATK-se).
3. Dëshmia 3 Vërtetimi nga gjykata kompetente (Origjinal ose kopje e noterizuar nga noteri).
4. • Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2, 3, i jep te drejte Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj si të papërgjegjshme ta bëjë konfiskimin e sigurimit të tenderit dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Kërkesa 1 Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.
2. Kërkesa 2 Regjistrimi i Numrit Fiskal.
3. Kërkesa 3 Regjistrimi i TVSH – së.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Dëshmia 1 Certifikatën e regjistrimit te Biznesit – se bashku me informatat për biznesin, te lëshuar nga Autoritetet e Regjistrimit te Biznesit – Kopje.
2. Dëshmia 2 Certifikatën e Numrit Fiskal – Kopje.
3. Dëshmia 3 Certifikatën e TVSH – Kopje.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

1. Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë jo më pak se 13,000.00 €.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Dëshmia 1 Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku Dy (2) kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.
2. Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet të ofroj Broshurat për produktet e ofruara

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Dëshmia 1 Lista e projekteve te kryera në lëmin e furnizimeve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Furnizimet e kryera, shumën e kontratës, vendit dhe Nr. e Prokurimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, e përcjellur me Kopje të Referencës ose Pranimit të furnizimeve të kryera.
2. Dëshmia 2 Broshurat apo katalogjet për produktet e ofruara.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vërejtje
1.	**"eor group", SHPK Deshmoret e Ponoshecit,**	**Prishtinë**	**6285,00 €**	**JO**
2.	**Grupi i OE "Matrix SHPK & X SHPK"**	**Prishtinë**	**5712,00 €**	**JO**

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.
Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Admirim Durguti– Kryetar i komisionit
- Selami Shterbani– Anëtar i komisionit
- Arben Gashi– Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

DEKLARATA përmban:
Komisioni vlerësues pas vlerësimit te tenderëve konstaton se Operatori Ekonomik "Eor Group" sh.p.k me adrese ne Prishtinë, i plotëson kushtet e caktuara ne dosjen e tenderit dhe është tenderuesi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet. Komisioni ne përbërje te plote rekomandon qe tenderi ti besohet kësaj kompanie.

- Është aprovuar vendimi i komisionit nga Menaxheri i prokurimit me date 16.05.2018.

Përgjigje në pretendimin ankimore të OE ankues "Matrix IM" shpk & X shpk"- Prishtinë..

Përgjigje për pretendimin 1, 2, 3, 4: " *1. Deklarata nën betim - mungon hederi dhe foteri si ne dosjen e tenderit pra nuk është numri i prokurimit dhe emri i projektit. 2. Te pozita, Shpresa Veliu ekziston si menaxhere ndërsa në dokumente te biznesit është si drejtoresh, kurse Adresa dallon nga dokumentet e biznesit. 3.Deklarata për specifikat teknike : Mungon numri i prokurimit dhe autoriteti kontraktues se kujt ju ka drejtuar 4.Deklarata për liferimin e pajisjeve nuk është konform kërkesë së AK-së sepse Mungon numri i prokurimit dhe emri i autoriteti kontraktues, prandaj nuk është e vlefshme."*

Përgjigje: Ky fakt nuk qëndron, pasi e gjithë përmbajtja e Deklaratave është e njëjte me deklarata si ne FDT andaj si Pretendim është i paqëndrueshëm

Përgjigje për pretendimin 5: *"Vërtetimi i gjykatës themelore Prishtinë, nuk është ofruar siç është kërkuar, kopje e noterizuar, por është ofruar vetëm kopje"*

Përgjigje: Sqarim ne baze te dosjes te tenderit përkatësisht vërtetimet te gjykatës i cili ndodhe pjesë e këtij dokumentacionit nga skanimi shihet çarte se është skanuar dokumenti origjinale dhe si pretendim i tille nuk qendrore, ne rast te ndonjë dyshimi AK gëzon te drejtën te kërkoj Origjinalin ose kopjen e noterizuar për verifikim.

Përgjigje për pretendimin 6: "*Pozicini 1, në paramasë është kërkuar vetëm 1 model nga AK, ndërsa OE i shpallur fitues i ka ofruar disa modele si p.sh janë ofruar 12 modele ku një pjesë e këtyre nuk i plotëson specikat teknike të parapara në paramasë. Pra OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me variante, ndërsa variantet me dosje të tenderit nuk kanë qenë të autorizuara. Katalogu_tasker* "

***Përgjigje,* Ky fakt nuk qëndron, për faktin se ne katalog ka pajisje te cilat i plotësojnë kriteret, dhe si e tille nuk e ndan katalogun vetëm për një produkt, mirëpo për te gjitha produktet e ofertuar.**

Përgjigje për pretendimin 7: *"OE fitues nuk ka specifikuar cilat konektor, po ashtu ka ofruar disa seri të konvektorëve prej faqes 27 deri ne 37, pra plotë IO faqe me konektor të ndryshëm. Pra OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me variante, ndërsa variantet me dosje të tenderit nuk kanë qenë të autorizuara. faqe 37 katalogu. NP3X-BAG-max. 0 7 mm.-SP55max. 0 5 mm.SP81max. 5 mm.-SP80max. 5 mm.SPF3XLRMmax. 0 7 mm.-SPM3XLRMmax. 7 mm.-SPS6.3max. 6,5 mm."*

***Përgjigje,* Ky fakt nuk qëndron, për faktin se ne katalog ka pajisje te cilat i plotësojnë kriteret, dhe si e tille nuk e ndan katalogun vetëm për një produkt, mirëpo për te gjitha produktet e ofertuar.**

Përgjigje për pretendimin 8: *"Mungojnë në tërësi specifikat teknike të PC-llaptopit të kërkuar dhe OE fitues nuk ka kod për tregtimin e PC në veprimtaritë e biznesit."*

***Përgjigje,* Ky fakt qëndron, kjo për faktin se sipas kërkesës kërkohet qe te gjitha produktet te kenë Katalog/broshure mirëpo OE nuk ka ofruar një dokument te tille.**

Përgjigje për pretendimin 9: *"Mungon në tërësi specifikimi teknik i projektorit, nuk është fare në katalog, ndërsa në FTD kërkohet broshura."*

***Përgjigje,* Ky fakt qëndron, kjo për faktin se sipas kërkesës kërkohet qe te gjitha produktet te kenë Katalog/broshure mirëpo OE nuk ka ofruar një dokument te tille.**

Përgjigje për pretendimin 10: *"Mungon ne tërësi specifikimi teknik i projektorit, nuk është fare në katalog ne FTD kërkohet broshura."*

***Përgjigje,* Ky fakt qëndron, kjo për faktin se sipas kërkesës kërkohet qe te gjitha produktet te kenë Katalog/broshure mirëpo OE nuk ka ofruar një dokument te tille.**

Përgjigje për pretendimin 11: *"AK ka kërkuar vetëm 1 mikset me 16 kanale, ndërsa OE fitues ka ofruar 2 modele 8 kanalesh dhe 16 kanalesh, ndërsa nuk i përkrah 740-786 MHZ dhe frekueca ne 150m katalogu i miksetes 3/16MPM SERIES MANUAL_v1.1, pra ka ofruar misket me të vogël se që ka kërkuar AK-ja.*
Mikseta nuk përkrah vifi mikrofon shih katalogun -PM_SERIES_MANUAL_v1.1

1. *Pozicioni i 2 Fumizim me 2 wireles hand mic -Pajisja e ofruar përkrah vetëm 1 dhe gjuha e përshkrimit teknik është bullgare.*

Komplet katalogu është ofruar në gjuhën bullgare i cili fakt është në kundërshtim me nenin 13 paragrafi 4 i LPP-së, prandaj OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm.
AK-ja ka kërkuar 40 hz deri 18000 hz, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar 50Hz - 15,OOOHz, Pra nuk janë përmbushur specifikimet teknike nga OE i rekomanduar për kontratë."

***Përgjigje,* Ky fakt qëndron, kjo për faktin se sipas kërkesës se AK-se, OE ka ofruar një Katalog/broshure ne gjuhen Bullgare dhe i njëjti sipas këtyre dokumenteve nuk plotëson kriteret minimale teknike.**

Andaj në bazë të të gjitha shkresave për këtë lëndë konstatoj se OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e parapara sipas njoftimit për Kontrate dhe rekomandoj qe ky Aktivitet te kthehet ne Rivlerësim.

Mendimi i ekspertit Teknik

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe ky aktivitet i prokurimit te kthehet ne Rivlerësim.